

Vjedhje e rëndë në Novosellë të Epërme – Hajnat marrin armë zjarri dhe 120 mijë euro para të gatshme



23/09/2025 19:43

f

t

e

Një rast i vjedhjes së rëndë është raportuar sot në orët e mëngjesit në fshatin Novosellë e Epërme, komuna e Gjakovës, ku persona të panjohur kanë depërtuar në një shtëpi private, duke vjedhur një armë zjarri dhe një shumë të konsiderueshme parash.

Zëdhënësi i Policisë për rajonin e Gjakovës, Sheremet Elezi, ka konfirmuar për mediat se ngjarja ka ndodhur rreth orës 08:30, raporton [lajmi.net](#)

“Sot, më 23.09.2025, rreth orës 08:30, në fshatin Novosellë e Epërme, është raportuar një rast i ‘Vjedhjes së rëndë’. Persona të panjohur kanë depërtuar në një shtëpi private, prej nga dyshohet se kanë vjedhur një armë zjarri – pistoletë me nëntë copë fishekë, si dhe një shumë të konsiderueshme të hollash,” tha Elezi.

Sipas tij, njësitë përkatëse policore kanë reaguar menjëherë pas raportimit, duke dalë në vendin e ngjarjes për të kryer ekzaminimet fillestare dhe për të mbledhur prova që mund të çojnë në identifikimin e të dyshuarve.

“Lidhur me rastin është njoftuar prokurori i shtetit, i cili në konsultim me hetuesit ka urdhëruar iniciimin e rastit si ‘Vjedhje e rëndë’. Aktualisht janë duke u ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe identifikimin e personave të dyshuar,” shtoi zëdhënësi Elezi.

Policia bën apel që të gjithë qytetarët që mund të kenë ndonjë informacion lidhur me rastin, ta raportojnë në stacionin më të afërt policor apo përmes numrave të kontaktit të Policisë së Kosovës./[Lajmi.net](#)/

LAJME TË FUNDIT

- 

Atentati ndaj Donald Trump në fushën e golfit,...
- 

Arifi: LVV-në e dikton Dejona, Urani dhe Beka janë definitivisht të pavarur
- 

Trump: NATO duhet të rrëzojë avionët luftarakë rusë,...
- 

Isak sapo nisi ta arsyetojë çmimin e madh,...

Artikuj të ngjashëm



September 23, 2025

Atentati ndaj Donald Trump në fushën e golfit, shpallet fajtor autori...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Gr. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information